

NEWSLETTER
E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#127

Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi përshëndeti organizimin e shqiptarëve në Londër



Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi përshëndeti sot organizimin e shqiptarëve në Londër me rastin e 100 vjetorit të marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve.

U zhvillua në Londër të Mbretërisë së Bashkuar Konferenca mbi 100-vjetorin e marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Pjesë e këtij aktiviteti janë pjesëtarë të diasporës shqiptare si dhe personalitete nga shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar, ndër të cilët Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Z. Taulant Balla, Kryetari i NënKomisionit për Diasporën dhe Migracionin, Z. Lavdrim Krashi dhe përfaqësues të shoqatave shqiptare në Londër në bashkëpunim me institucionet e Mbretërisë së Bashkuar.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimim e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

Drejtoresha Ekzekutive e AKD-së, znj. Sonila Hysi vizitë në shkollën e mësimit plotësues të krijuar nga shoqata shqiptare "Ardhmëria" në Londër

Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi gjatë vizitës shkollën e mësimit plotësues të krijuar nga shoqata shqiptare "Ardhmëria" në Londër, Angli. "Ardhmëria" kryesuar nga Z. Lutfi Vata, njëkohësisht "Ambasador Kombi" i Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, punon intensivisht në ruajtjen e gjuhës shqipe dhe trashëgimisë kulturore për komunitetin shqiptar në Londër.

Të pranishëm në këtë vizitë ishin edhe Z. Balla, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Z. Veliqaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë. Nxënësit shqiptarë në Londër ia dedikojnë çdo të shtunë mësimin të gjuhës dhe kulturës shqiptare ku mësojnë dhe kultivojnë gjuhën dhe kulturën shqipe si dhe ruajnë trashëgiminë kombëtare.



Aplikacioni "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare" zëri i biznesit në Diasporë

Gjithçka në "pëllëmbë të dorës" nëpërmjet aplikacionit "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare - ADBC". Informacion të arritshëm për bizneset, sipërmarrësit, anëtarët e Diasporës në Shqipëri, si dhe funksione të ndryshme

Shqipëria e Kosova prezantojnë tekstin e përbashkët për mësimin e gjuhës shqipe



Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të Republikës së Kosovës, ka prezantuar tekstin përbashkët "Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare", Niveli I.

Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, u shpreh se ky takim shenjon një arritje të rëndësishme në procesin e njësimit të politikave të të dy vendeve në fushën e mësimdhënies në Diasporë. Tashmë, në shkollat shqipe jashtë vendit, Shqipëria dhe Kosova do të kenë të njëjtën qasje ndaj gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare, duke vërtetuar se diaspora dhe gjuha shqipe na bëjnë bashkë duke shkrirë të gjitha dallimet gjeografike, historike, politike e kulturore.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

QSPA: Synimet e konferencës për "Arbëreshët në fokusin e shtetit shqiptar"

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët ka organizuar konferencën shkencore me temë: "Arbëreshët në fokusin e shtetit shqiptar". Një veprimtari që mbledhi së bashku disa nga studiuesit më të rëndësishëm shqiptar për të trajtuar një sërë temash mbi marrëdhëniet dhe ndërshkëmbimet ndërmjet arbëreshëve dhe shtetit shqiptar.

Konferenca e organizuar nga Qendra e Studimeve dhe e Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) në bashkëpunim me Institutin e Historisë të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA) u fokusua te disa nga aspektet kryesore të ndërkëmbimeve mes diasporës historike me vendin amë në aspektin kulturor, ekonomik, shoqëror, politik etj.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë



Diaspora Shqiptare

Aplikacioni Gazeta
"Diaspora Shqiptare"


SHKARKO
APLIKACIONIN FALAS

App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

DHURO LIBRA!

PËR SHTETASIT SHQIPTARË
QË VUAJNË HEQJEN E LIRISË
JASHTË VENDIT

Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.



Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

Për më shumë informacione nga Diaspora vizitoni

www.diasporashqiptare.al